




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë:19.04.2024



Npi – 01/144 datë: 29.04.2024

Duke u bazuar në nenin 12 shkronja (d) dhe nenit 40 shkronja (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Në bazë të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008, si dhe në bazë të propozim-vendimit Nr.02/317 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/248 të datës 27.06.2023 për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 29.04.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi-01/248 TË DATËS 27.06.2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për SHFUQIZIMIN e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/248 të datës 27.06.2023 për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të.

II

A r s y e t i m: Duke marrë për bazë në mënyrë analogjike nenin 51 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), si dhe nenin 14 të Udhëzimi Administrativ të (MPL) Nr.05/2020, Komisionet të cilat i formon Kuvendi duhet të reflektojnë përbërjen e strukturës politike të Kuvendit, e që në këtë rast subjektet e pozitës: LVV-ë, LDK-ë dhe AKR-ë si koalicion nuk kanë qenë fare të përfaqësuar në përbërjen e Komisionit, me rastin e marrjes së vendimit Npi-01/248. Arsyeja e dytë për shfuqizimin e vendimit Npi-01/248 është se tre anëtarët e komisionit për verifikimin e ndarjes së subvencioneve për (OJQ) që nga miratimi i vendimit më datën 27.06.2023 e deri më datën 18.04.2024, kur është propozuar shfuqizimi i këtij vendimi, nuk kanë paraqitur asnjë lloj interesimi për ta realizuar punën e tyre për të cilën edhe janë votuar. Kuvendi i Komunës e ka marrë parasysh rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ka analizuar propozimin Nr.02/317 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, dhe me shumicën e votave ka marrë vendim, sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komisionit, Drejtorisë, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi